



ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS – FABREFACTA – OPTIME

PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE TË CILËT APLIKOJNË PËR TRANSFERIM STUDIMESH

Transferimet e studimeve, nga një institucion i arsimit të lartë drejt një tjetri, lejohen për programe brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta me programin e studimit aktual që studenti është duke ndjekur.

Aplikimet e transferimeve përcaktohen me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe lejohen vetëm një herë në vit, në fillim të vitit akademik.

“**Albanian University**”, për vitin e ri akademik **2021-2022** do të ofrojë mundësinë për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda këtij universiteti, apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, publike ose private, vendase ose të huaja. Programet e studimit dhe detyrimet e shlyera në institucione të tjera njihen dhe ekuivalentohen nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.

Njohja e krediteve dhe vendimi për transferim të studimeve në AU, bëhet nga Komisioni i Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve, mbështetur në rregullat dhe udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë, duke respektuar parimet e Kartës së Bolonjës që dispijlojnë procedurat e mobilitetit të studentëve. Njohja e lëndëve/moduleve dhe krediteve bëhet duke pasur parasysh kreditet e lëndës dhe programin e lëndës.

Kandidatët të cilët aplikojnë për transferim studimesh, duhet të respektojnë edhe kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave të vitit akademik që studenti është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016-2017 dhe në vijim.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin pranë Zyrës së Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve, në “Albanian University” është si më poshtë vijon:

1. Kërkesë drejtuar Albanian University, për transferim studimesh (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës Nr.6 të udhëzimit Nr.17, datë 30.07.2019);
2. Planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse;
3. Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë (Studentët që transferojnë studimet nga një IAL e huaj, planin e plotë të programit me syllabuset dhe listën e notave, duhet t'i dorëzojnë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njehsuara me origjinalin);
4. Fotokopje të noterizuar të Diplomës së shkollës së mesme dhe në mungesë të saj, Dublikatë të lëshuar nga Drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar/Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar ose listën e notave të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;
5. Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
6. Dy fotografi personale.



ALBANIAN UNIVERSITY

UNIVERSITAS – FABREFACTA – OPTIME

PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE TË CILËT APLIKOJNË PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI

“Albanian University”, për vitin e ri akademik **2021-2022** do të ofrojë mundësinë për aplikim dhe regjistrim në programet e ciklit të dytë të studimeve.

Të drejtën për të ndjekur një program të dytë studimi në “Albanian University”, e kanë të gjithë ata studentë të cilët e kanë përfunduar një program studimi të të njëjtit cikël.

Kandidatët të cilët aplikojnë për program të dytë studimi, duhet të respektojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.436 dt.3.6.2020, ndryshuar me VKM Nr.46,dt. 27.1.2021.

Aplikimet për programet e dyta të studimit kryhen pranë Zyrës së Transferimit dhe Ekuivalentimit të Studimeve në afatet e përcaktuara me udhëzim nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët pranë ZETS, është si më poshtë vijon:

1. Kërkesë drejtuar Albanian University, për ndjekjen e një programi të dytë studimi (ose formuari i aplikimit sipas shtojcës Nr.6 të udhëzimit Nr.17, datë 30.07.2019);
2. Kopje të noterizuar të diplomës së studimeve universitare të kryer më parë të shoqëruar me Supplementin e diplomës;
3. Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për njohjen e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;
4. Fotokopje të noterizuar të Diplomës së shkollës së mesme ose në mungesë të saj, Dublikatë të lëshuar nga Drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar/Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar ose listën e notave të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;
5. Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
6. Dy fotografi personale.